



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DHURATA VARDHAMI
ADRESA RR. SAMI FRASHERI
TEL: 0674110083

PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 4

Nr. koleksioni: 2

Tirane më 10/01/2023



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2023054130000188976





PROKURË E POSAÇME



Sot, më datë 10.01.2023 (dymijënjëzetetë), para meje Notere Dhurata Vardhami, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me adresë Rr. Sami Frashëri, Tiranë, u paraqitën personalisht:

TË PËRFAQËSUARIT:

Z. Luigi Febbrari, shtetas italian, lindur më datë 04.07.1951, në Castenedolo (BS), Itali, me banim në Via Pietro Pisa, 51, Castenedolo (BS) Itali, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me anë të kartës së identitetit me nr. CA30506DC lëshuar më datë 18.01.2019 dhe mban datë skadence 04.07.2029; **dhe**

Z. Luca Laurenti, shtetas italian, lindur më datë 02.07.1989, në Terni (TR), Itali, me banim në Terni, Itali, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me anë të pasaportës italiane me nr. YB1821899 lëshuar më datë 07.09.2017 dhe mban datë skadence 06.09.2027.

Të cilët me dëshirën e tyre të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkuan nga unë Noterja redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 “Për Noterinë”, si më poshtë vijon:

i lëshojnë prokurë të Posaçme **Av. Dr. Lulzim Alushaj**, identifikuar si individ me kartë identiteti nr. H71208026J dhe i regjistruar si person fizik në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin tregtar “**LEGALE ALBANIA**” me NUIS: L41320065B, me adresë kryesore në Rruga “Myslym Shyri”, DOMUS Residence, Kati 4, Suitat 16 – 17, Njësia Bashkiake nr. 10, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri (nga tani e në vijim “Përfaqësuesi”), që në emër e për llogari të të Përfaqësuarve të ketë të gjithë tagrat e nevojshme dhe kompetencat e plota për të përfaqësuar të Përfaqësuarit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe në të gjitha zyrat e tjera të administratës publike e shtetërore në lidhje me regjistrimin fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nëpërmjet portalit *e-Albania*, shoqëri e re ku Z. Luigi Febbrari do të jetë ortak dhe njëkohësisht administratori i vetëm i saj dhe ortak Z. Luca Laurenti. Përfaqësuesit i jepet e drejta të regjistrojë në çdo kohë Statutin e nënshkruar më datë 08.11.2022 dhe aktet e tjera të regjistrimit të shoqërisë së re në portalin *e-albania* dhe të kryejë çdo veprim tjetër juridik deri në lëshimin e Certifikatës së Regjistrimit të shoqërisë së re nga institucioni kompetent QKB.

Për realizimin e objektit të kësaj prokure i jepen Përfaqësuesit këtu të emëruar të gjitha tagrat e nevojshme për të përfaqësuar të Përfaqësuarit, ndër të tjera, në sa vijon:



A2023054130000188976

- të kryejë dhe dërgojë aplikimin online në shërbimin e regjistrimit fillestar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nëpërmjet platformës e-albania që kanë për qëllim përmbushjen e kësaj prokure;
- të tërheqë, kërkojë, depozitojë dhe ngarkojë online dokumentacionet e nevojshme në emër dhe për llogari të të Përfaqësuarit;
- të nënshkruajë në çfarëdolloj forme të kërkuar nga ligji, elektronikisht apo fizikisht çdo dokumentacion, si formularë aplikimesh, kërkesa dhe dokumenta të tjera që megjithëse nuk janë përmendur në këtë prokurë i përkasin praktikës së sipër cituar, për llogari të të Përfaqësuarit;
- të shqyrtojë, të kërkojë informacion, të mbajë korrespondencë me firmën e tij, të tërheqë kopje dokumentash që nga Përfaqësuesi konsiderohen të dobishme ose të nevojshme pranë institucioneve shtetërore, publike dhe ato private për praktikën e aplikimin e sipër cituar, të gjitha në emër dhe për llogari të të Përfaqësuarëve, për të përmbushur qëllimin e kësaj prokure.
- të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme pranë zyrave kompetente publike, shtetërore e private, të cilat edhe pse nuk janë përshkruar në këtë prokurë, ato kanë për qëllim përmbushjen e tagrave dhe kryerjen e veprimeve në lidhje me regjistrimin fillestar të shoqërisë.

Autorizohet Përfaqësuesi dhe personat e emëruar prej tij në bazë të kësaj prokure për të trajtuar të dhënat e të Përfaqësuarëve, për t'i përdorur konform objektit të kësaj prokure, t'i komunikojë ato bashkëpunëtorëve dhe zëvendësuesve të mundshëm si dhe për t'i shpërndarë këto të dhëna në kufijtë e parashikuar në angazhimin e dhënë.

Kështu që, i emëruari si Përfaqësues pajiset me çdo pushtet të nevojshëm për të bërë gjithçka që është e dobishme dhe e përshtatshme për kryerjen e këtij mandati, që asnjë fuqi nuk mund t'i kundërvihen ose t'i mungojë Përfaqësuesve.

Të përfaqësuarit deklarojnë shprehimisht se aprovojnë dhe konsiderojnë si të vlefshme veprimet e kryera nga ana e Përfaqësuesit në emër dhe për llogari të të Përfaqësuarëve brenda limiteve të objektit të kësaj prokure, që do të kryhen nën detyrimet e ligjit shqiptar.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. Të përfaqësuarit deklarojnë se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njeher legjislacioni në fuqi në shtetin Shqiptar, do t'i konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të Përfaqësuarëve, i cili e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noteres.



A2023054130000188976

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noteres në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarëve. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjera për të përfaqësuarit dhe përfaqësuesin e tyre.

Unë Noterja, verifikova identitetin e të përfaqësuarëve nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Pasi ju lexua me zë të lartë e të qartë, Z. Luigi Febbrari dhe Z. Luca Laurenti, në praninë e përkthyesit të gjuhës Italiane Zj. Anxhela Seferi, të cilët e kuptuan, pranuan përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruan atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi, në përputhje të plotë me ligjin nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

TE PËRFAQËSUARIT

Z. Luigi FEBBRARI

LUIGI FEBBRARI
Luigi Febbrari

Z. Luca LAURENTI

LUCA LAURENTI
Luca Laurenti

PËRKTHYESE

Anxhela Seferi
Anxhela Seferi

NOTERE

Anxhela Seferi

AS



[Faint handwritten signature and illegible text]



[Faint circular stamp impression, likely a duplicate of the official stamp above]